



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

I mbledhjes së njëmbëdhjetë i Komitetit për Politikë dhe Financa e Komunës së Prishtinës, mbajtur më 13.12.2024.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina - kryesues i komitetit, Nora Kelmendi (VV), Arbnora Berisha (VV), Gëzim Sveçla (VV), Jeta Rafuna (LDK), Dhurata Jahaj - Retkoceri (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shegë Beqiri - Badivuku (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK) dhe Bahri Gashi (AAK).

Mungoi: Mirsad Vitia (VV).

E pranishme ishte edhe: Valbona Makolli - drejtore e Drejtorisë së Financave.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina, kryesues i komitetit, me këtë:

REND DITE

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit i mbledhjes së nëntë dhe të dhjetë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës, për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2024 (TM3);
3. Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Agim (Nezir) Zymberit dhe Nazif (Sabit) Gajtanit;
4. Propozim-vendimi lidhur me Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2024- 2026;
5. Propozim-vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit për vitin 2025;
6. Informatë për fillimin e vitit shkollor 2024-2025 në kryeqytet;
7. Raporti vjetor i punës për vitin 2023 lidhur me punën e komisionit të aksionarëve, të Ndërmarrjes publike “Termokos“, SH.A;
8. Pyetje dhe përgjigje;
9. Të ndryshme.

Kryesuesi: – tha se i kam dy propozime për këtë rend të ditës dhe vazhdoi me pikat e rendit të ditës. Propozim-vendimi për kompenzimin vjetor financiar për punëtorët e administratës të Komunës së Prishtinës dhe propozim-vendimi për vënien në diskutim publik për Rregulloren për kompenzim ditor për financim të ushqimit për të punësuarit në Komunën e Prishtinës. Ai tha se duke u bazuar në Ligjin për Kryeqytetin nr. 06/L-012 të datës 06.06.2018, nenin 17, paragrafi 4,

dhe neni 19, kërkojmë kompensim vjetor për puntorët e administratës në vlerë 1300 (një mijë e treqind) euro bruto apo 1200 (një mijë e dyqind) euro neto.

Valbona Makolli: – tha se unë nuk jam kundër këtij propozimi vetëm sa për sqarim, sa i përket vitit 2024, është bërë mbyllja e zotimeve të mjeteve, këtë javë kemi në dispozicion vetëm shpenzimet e mjeteve financiare. Drejtoresha tha sipas propozimit këto dy vendime kanë vlerë diku 3,570,000 euro, pasi që nuk është bërë ndarja vetëm për staf civil por në të janë të përfshirë edhe ata me kontrata trivjeçare, të emëruarit politik dhe asamblastët.

Leutrim Retkoceri: – tha se kemi pranuar një kërkesë të kompanisë regjionale të pastrimit ku për shkak të rrethanave mbase edhe të rregullores kanë kërkuar subvencionimin nga Komuna e Prishtinës për arsye të rrezikimit të pagave për puntorët për muajin dhjetor dhe janar.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së nëntë dhe të dhjetë të Komitetit për Politikë dhe Financa, me të gjitha votat për, kalon si pikë e rendit të ditës.

Pika e dytë

Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës, për periudhën 1 korrik – 30 shtator 2024 (TM3).

Valbona Makolli: - tha se vetëm për informim që sipas Ligjit të Buxhetit një muaj pas periudhës së raportimit jemi të obliguar që ta dërgojmë për publikim. Prandaj tha se nuk po më duket e arsyeshme t'ju marr kohë më shumë dhe të hyjë në detaje më të thella.

Pika e tretë

Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Agim (Nezir) Zymberit dhe Nazif (Sabit) Gajtanit.

Bahri Gashi: - tha se ne jemi dakorduar njëherë që nëse nuk i kemi drejtorët për të na dhënë sqarim për pikat të cilat i kemi në rend të ditës t'i largojmë ato automatikisht nga ky rend i ditës. **Me 4 vota për, 6 vota kundër.**

Pika e tretë

Propozim-vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Agim (Nezir) Zymberit dhe Nazif (Sabit) Gajtanit, hiqet nga rendi i ditës.

Pika e katërt

Propozim-vendimi lidhur me Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026.

Premtime Preniqi: – tha se Plani për Barazi Gjinore 2024-2026, ka kaluar diskutimin publik, ku ne kemi pranuar kërkesat dhe i kemi inkuadruar në plan ato të cilat i kemi parë të arsyeshme. Prandaj besoj se është i gatshëm për të kaluar në Kuvend.

Me të gjitha votat njëzëri për, kalon edhe pika e katërt e rendit të ditës - Propozim-vendimi lidhur me Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026.

Pika e pestë

Propozim-vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit për vitin 2025.

Kryesuesi: – tha se për këtë pikë të rendit të ditës hapi diskutimin në seancë të Kuvendit.

Pika e gjashtë

Informatë për fillimin e vitit shkollor 2024-2025 në kryeqytet.

Kryesuesi: – tha se për sqarimin e kësaj pike të rendit të ditës mungon drejtoresha Lushaku.

Pika e shtatë

Raporti vjetor i punës për vitin 2023, lidhur me punën e komisionit të aksionarëve të Ndërmarrjes publike “Termokos”, SH.A.

Këtë pikë të rendit të ditës e diskutojmë në seancë të Kuvendit.

Leutrim Retkoceri: – tha se propozimin e mëhershëm për subvencionimin e Ndërmarrjes “Pastrimi”, janë dy çështje me të cilat mund ta arsyetojmë. E para është se më pagesat e faturave të kësaj ndërmarrjeje për shërbimet me njësi të klientëve është bërë pagesa e operatorit privat. Dhe sipas kësaj ndërmarrjeje ju janë krijuar obligime gjë e cila rrezikon edhe mospagesat e punëtorëve për muajt dhjetor dhe janar. Retkoceri tha se çështja tjetër është se sipas vendimit të fundit të miratuar në Kuvend kompania nga muaji janar duhet ta bëjë vetë shpërndarjen e faturave dhe pastaj të fillojë me inkasimin e që i duhet kohë. Prandaj ai shtoi në mënyrë që mos t’u rrezikojmë punëtorëve pagat në këto kohë feste kërkojmë ndarjen e një subvencioni ashtu siç ka ndodhur edhe vitin e kaluar.

Valbona Makolli: – tha se sa i përket subvencionimit dje është bërë zyrtarisht mbyllja e zotimit të mjeteve, edhe nëse hipotetikisht e marrim vendimin derisa ta dërgojmë për shqytrim të ligjshmërisë në ministri dhe derisa ta kemi një përgjigje, vetëm hyjmë në obligime për pagesa në vitin e ardhshëm. Ajo tha se nëse ju duhen fatura jam e gatshme të ju sjell deri në 10 raporte, derisa ta nxjerrim stafin nga kjo pengesë, mirpo unë nuk e di që kanë obligime të pagave ose faturave që janë sjellë nga pastrimi.

Leutrim Retkoceri: – tha se do të ishte mirë me i sjell faturat apo raportet të cilat janë bërë. Ai tha se tash pranova edhe një material ku shihet se në muajin maj të vitit 2024, vlera e faturave që janë ndarë është 367 mijë euro, ndërsa pagesa është bërë 312 mijë euro dhe pagesa që është bërë

për operatorët privat është 110 mijë euro. Tutje tha se sipas kësaj ata është dasht të lënë diçka për t'i kryer pagesat për punëtorët e ndërmarrjes.

Bahri Gashi: – tha se vetëm do ta pyes drejtoreshën për këtë vendim por edhe atë të shujtave që nëse i miratojmë, a kemi mundësi për ndarjen e këtyre mjeteve. Ai tha se nëse ne marrim ndonjë vendim dhe nuk mundemi t'i ekzekutojmë mjetet atëherë do të ishte dy herë më keq për ata punëtorë, të cilët presin t'i marrin këto mjete.

Valbona Makolli: – tha se nuk jam kundër këtyre vendimeve apo ndarjeve të mjeteve për puntorë, por në dëgjimet buxhetore të cilat i kemi mbajtur dhe propozimeve që janë dhënë për buxhetin e vitit 2025, ne nuk kemi pranuar asnjë kërkesë në lidhje me shujtat e punëtorëve në mënyrë që të përfshihen në buxhet.

Bahri Gashi: - tha se vetëm mos të ju japim shpresë punëtorëve nëse të njëjtën nuk mundemi edhe ta realizojmë. Gashi tha se edhe pse për këtë vit kemi përmbyllje buxhetore ne do ta votojmë vendimin dhe të shohim mundësinë që të njëjtin ta realizojmë në muajin janar të vitit të ardhshëm.

Mbledhja mbaroi në orën 09:20.

**Procesmbajtësi
Arton Brahim**

